

**KËSHILLI I INVESTIMEVE  
PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË  
MBLEDHJES XXXVII**

***“Mbi Sigurinë Juridike të Pronës – Progresi dhe Sfidat”***

**Tiranë, 20 prill 2026, 15:00 – 17:00**

Mbledhja u drejtua nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, znj. Delina Ibrahimaj, Kryetare e Këshillit të Investimeve (KI). Në mbledhje morën pjesë 16 anëtarë të KI dhe 30 vëzhgues – përfaqësues të shoqatave të biznesit vendas dhe të huaj dhe institucioneve shtetërore në Shqipëri.

**I. Hapja e Mbledhjes nga Ministria Delina Ibrahimaj, Kryetare e KI**

Në fjalën e saj hyrëse, Ministria Ibrahimaj përshëndeti pjesëmarrësit dhe theksoi rëndësinë e temës së diskutimit për klimën e biznesit në vend, duke e cilësuar atë si një çështje mjaft të rëndësishme dhe historikisht sfiduese. Ajo nënvizoi se nuk do të ndalej në detaje teknike, pasi ato do të prezantohen nga Sekretariati i KI.

Në vijim, ajo theksoi progresin e qeverisë në digjitalizimin e administratës publike dhe shërbimeve, ku mbi 95% e tyre janë tashmë të digjitalizuara. Ajo përmendi përpjekjet e vazhdueshme për thjeshtimin dhe riorganizimin e proceseve administrative (derregullimin dhe ri-inxhinierimin e shërbimeve), veçanërisht ato të dedikuara për biznesin, në bashkëpunim me institucionet përkatëse. Ministria njoftoi gjithashtu një nismë të re ligjore që synon që çdo akt normativ të analizojë nëse rregullon, mbirregullon apo lehtëson proceset e ofrimit të shërbimeve, me qëllim përshpejtimin dhe thjeshtimin e tyre.

Sa i përket kadastrës, ajo theksoi procesin në vijim të digjitalizimit të shërbimeve të saj, i cili është pjesë e Planit të Rritjes dhe Agjendës së Reformave të dakordësuar me Bashkimin Evropian. Ajo vlerësoi punën e bërë në këtë drejtim dhe u shpreh se hapësirë më e gjatë do t'i jepej Drejtoreshës së Kadastrës për një prezantim më të detajuar.

Në vijim, Ministria theksoi nevojën për forcimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të KI, duke iu referuar konsultimeve të vazhdueshme me BERZH-in dhe SECO-n. Qeveria synon të ndërtojë struktura të qëndrueshme dhe funksionale, të cilat mund të operojnë plotësisht edhe përtej mbështetjes së donatorëve. Në këtë kontekst, Ministria nënvizoi nevojën për konsolidimin e disa këshillave ekzistuese të biznesit nën një kornizë gjithëpërfshirëse. Ministria Ibrahimaj theksoi, si në cilësinë e kryetares aktuale të KI-së ashtu edhe si anëtare në faza të ndryshme më herët, se KI përfaqëson një nga platformat më të suksesshme të dialogut publiko-privat, për shkak të profesionalizmit dhe rolit të saj në lidhjen efektive ndërmjet komunitetit të biznesit dhe qeverisë. Duke u mbështetur në këtë bazë, synimi është zgjerimi i mëtejshëm i fushëveprimit të Këshillit, me qëllim lehtësimin e konsultimeve dhe diskutimeve ku biznesi dhe qeveria marrin pjesë si palë të barabarta dhe japin rekomandime, duke u mbështetur në struktura profesionale që angazhohen në analizën dhe ndjekjen e zbatimit të tyre.

Në mbyllje, Ministria theksoi se çdo vendimmarrje e mëtejshme do të hartohet përmes konsultimit me anëtarët e KI-së dhe propozoi që mbledhja e radhës të përfshijë një diskutim të thelluar mbi këtë çështje, të bazuar gjithashtu në një informim gjithëpërfshirës që do të përgatitet.

**Znj. Ekaterina Solovova, BERZH**, u shpreh se BERZH mirëpret nismën e Qeverisë për të rishikuar një model të qëndrueshëm për një platformë dialogu si Këshilli i Investimeve. Ajo vuri në dukje se, siç është diskutuar edhe me Ministren dhe SECO-n, partner dhe donator i kësaj nisme, Banka është e hapur për të shqyrtuar ide dhe qasje të reja, me kusht që të ruhen parimet themelore mbi të cilat bazohet kjo platformë. Ajo theksoi se KI njihet gjerësisht si një nga forumet më efektive të dialogut publiko-privat, një vlerësim i përforcuar nga vetë anëtarët e tij, nga vlerësimet e fundit të jashtme, si edhe gjatë festimit të 10-vjetorit të tij. Znj. Solovova nënvizoi nevojën për të ruajtur një balancë mes parimeve ekzistuese dhe prioritizimit të qëndrueshmërisë, duke shtuar se ky proces duhet të zhvillohet në mënyrë të strukturuar dhe me përfshirjen e anëtarëve të KI-së. Në fund, ajo mbështeti propozimin e Ministres që diskutimi mbi këtë çështje të vijojë në mbledhjen e radhës së KI-së.

**Z. Philipp Arnold, Ambasada e Zvicrës**, theksoi angazhimin e Qeverisë Zviceriane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) në mbështetje të Këshillit të Investimeve që prej vitit 2019. Ai vlerësoi si të përshtatshme kohën aktuale për të diskutuar mbi qëndrueshmërinë e Këshillit dhe mënyrën e ruajtjes së këtij formati edhe në të ardhmen, duke theksuar se kjo është një çështje që kërkon përfshirjen aktive të vetë anëtarëve për të përcaktuar se çfarë duhet ruajtur dhe çfarë mund të përmirësohet. Më tej, ai nënvizoi si thelbësore pavarësinë e Këshillit dhe rolin profesional të Sekretariatit, i cili mbështet përgatitjen e temave dhe analizave të thelluara që shërbejnë si bazë për diskutimet në mbledhje. Në përfundim, ai shprehu gatishmërinë e Zvicrës për të vijuar mbështetjen dhe për të kontribuar në diskutimet mbi qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të KI.

## **II. Përparimi i Digjitalizimit dhe Modernizimi i Shërbimeve Kadastrale: Progresi dhe Sfidat në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK)**

**Znj. Lorena Goxhobelli, ASHK**, vlerësoi mundësinë e këtij diskutimi të hapur mbi çështjet që lidhen me pronën dhe prezantoi progresin kryesor të institucionit, duke theksuar se viti 2025 ka qenë intensiv për digjitalizimin dhe proceset e regjistrimit fillestar. Ajo njoftoi se kartelat e digjitalizuara kanë arritur rreth 90%, ndërsa skanimi i plotë i dokumentacionit (rreth 54 milionë faqe) ka përfunduar dhe synohet finalizimi i plotë i digjitalizimit të kartelave deri në qershor 2026. Paralelisht, po vijon puna për digjitalizimin e hartave kadastrale me mbështetjen e BE-së dhe UNOPS-it, me synimin për një kadashtë plotësisht digjitale deri në fund të vitit 2026. Ajo theksoi gjithashtu zgjerimin e shërbimeve të automatizuara dhe rritjen e volumit të tyre, me qëllim përmirësimin e shpejtësisë dhe cilësisë së shërbimit, si dhe punën në 177 zona kadastrale urbane dhe rurale në kuadër të regjistrimit fillestar, si një proces kyç për formalizimin e pronës dhe nxitjen e qarkullimit ekonomik të pasurive. Në aspektin e performancës, ajo raportoi 2.5 milionë shërbime të ofruara në vitin 2025 (+35% krahasuar me 2024) dhe 260 mijë certifikata pronësie (+53%), si dhe reduktim të ndjeshëm të kohës së trajtimit të aplikimeve në mesatarisht 2–3 ditë mbi afatet ligjore. Më tej, ajo shpjegoi funksionimin e sistemit të aplikimeve përmes noterëve dhe e-Albania, duke theksuar se rreth 60% e aplikimeve vijnë nga noterët dhe se mbetet nevojë për përmirësim në korrektësinë e aplikimeve dhe pagesave. Ajo pranoi ekzistencën e perceptimeve për korrupsion, ndërsa nënvizoi se institucioni po zbaton planin e integritetit 2025–2027 dhe masa të forcuara kontrolli e monitorimi, duke shprehur në fund gatishmërinë për sugjerime dhe diskutime të mëtejshme.

## **III. Prezantim i Sekretariatit mbi analizën për digjitalizimin dhe administrimin kadastral në funksion të sigurisë juridike të pronës dhe klimës së investimeve**

**Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI**, prezantoi gjetjet kryesore të analizës mbi digjitalizimin dhe administrimin kadastral, duke u fokusuar në ndikimin e tyre në sigurinë juridike të pronës dhe klimën e investimeve. Analiza, e bazuar në 146 përgjigje dhe konsultime me biznesin dhe institucionet, evidentoi sfida lidhur me aksesin në shërbime, standardizimin e procedurave, dokumentacionin shtesë, vonesat, tarifat dhe koordinimin institucional. Ndërsa u theksua nevoja për më shumë akses në të dhëna, unifikim procedurash dhe rritje të transparencës. Rekomandimet kryesore përfshijnë standardizimin e procedurave, zgjerimin e aksesit për profesionistët, përmirësimin e transparencës dhe forcimin e mekanizmave të ankesave dhe monitorimit, si dhe përfshirjen më aktive të biznesit në monitorimin e reformave.

#### **IV. Përmbledhje e diskutimeve kryesore**

**Z. Zak Topuzi, Shoqata Shqiptare e Turizmit**, theksoi se problematikat që lidhen me pronësinë e tokës dhe mungesa e një digjitalizimi të plotë të të dhënave kadastrale krijojnë pasiguri dhe vonesa në zhvillimin e projekteve, veçanërisht për marrjen e lejeve të ndërtimit. Ai shpjegoi se në disa raste informacioni mbi statusin apo destinacionin e tokës nuk është i saktë ose ndryshon ndërmjet institucioneve, duke e bërë të vështirë për bizneset të planifikojnë investimet. Po ashtu, pasaktësitë në regjistrimin e pronave dhe mungesa e koordinimit ndërinstitucional mund të sjellin konfuzion dhe rreziqe për investitorët. Në këtë kuadër, ai theksoi nevojën për një sistem të unifikuar, të digjitalizuar dhe të besueshëm të të dhënave të pronës, që të sigurojë qartësi dhe parashikueshmëri për qytetarët dhe bizneset.

**Znj. Lorena Goxhobelli, ASHK**, sqaroi se shqetësimet e ngritura për regjistrimin e lejeve të ndërtimit po adresohen përmes krijimit të një regjistri digjital të lejeve të ndërtimit, i cili funksionon mbi bazën e një marrëveshjeje me institucionet përkatëse (AZHT, bashkitë dhe noterët). Ky sistem synon që regjistrimi i të dhënave të mos bëhet më nga ndërtuesit, por drejtpërdrejt nga institucionet lëshuese të lejeve, duke rritur transparencën dhe shmangur regjistrimet manuale dhe vonesat. Ajo u shpreh se sistemi është në fazën përfundimtare të testimit dhe pritet të fillojë regjistrimin e lejeve të para së shpejti.

Sa i përket ndryshimeve në përdorimin e tokës (PDV), ajo sqaroi se këto nuk janë kompetencë e Kadastrës, por e autoriteteve të planifikimit të territorit dhe bashkive, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, të cilat përcaktojnë destinacionin dhe intensitetin e ndërtimit të tokës.

Më tej, ajo u shpreh se procesi i digjitalizimit është shumë intensiv dhe përfshin një volum të madh të dhënash, ndaj mund të ndodhin pasaktësi teknike gjatë përpunimit. Ajo sqaroi se këto gabime nuk nënkuptojnë ndryshim të pronësisë apo transferim të pronës, por janë vetëm pasaktësi në të dhëna që korrigojnë lehtësisht nga sistemi. Ajo nënvizoi se pronësia mbetet e pandryshuar dhe nuk ka vend për shqetësim apo panik, pasi çdo mospërputhje e identifikuar korrigohet menjëherë nga institucionet përkatëse.

**Ministër Delina Ibrahimaj**, theksoi se rastet e ngritura duhet të analizohen individualisht, ndërsa sqaroi se ndryshimet në përdorimin e tokës (PDV) janë kompetencë e bashkive, të cilat miratojnë planet e zhvillimit sipas interesit publik dhe strategjive të tyre territoriale.

Ajo vlerësoi gjithashtu regjistrin digjital të lejeve të ndërtimit, duke theksuar se ky sistem do të reduktojë problematikat ekzistuese, pasi do të sigurojë që të dhënat të regjistrohen paraprakisht dhe të aksesohen në mënyrë të unifikuar nga institucionet përkatëse. Sipas saj, kjo do të shmangë pasaktësitë dhe ndryshimet e mëvonshme që krijojnë pasiguri për pronat.

**Z. Zak Topuzi, Shoqata Shqiptare e Turizmit**, sqaroi se në rastet e përmendura janë marrë lejet përkatëse dhe miratimet institucionale, përfshirë edhe prefekturat, ndërsa theksoi se problemi lidhet me mungesën e rakordimit ndërinstitucional të dokumentacionit.

**Z. Erjon Harizi, Shoqata e Ndërtuesve**, ngriti një nga problematikat kryesore që hasin ndërtuesit në lagjet e vjetra të Tiranës, si Pazar i Ri, e lidhur me mënyrën historike të regjistrimit të pronës dhe zhvillimit urban para dhe pas tranzicionit. Ai shpjegoi se në të kaluarën nuk ka ekzistuar një sistem i plotë dhe i standardizuar kadastral, duke bërë që regjistrimi i pronës të jetë shpesh i pjesshëm: në disa raste, qytetarët nuk kanë hipotekuar rrugicat apo hapësirat e përbashkëta, duke i konsideruar si pronë shtetërore, ndërsa në të tjera raste është regjistruar vetëm sipërfaqja e banueshme si pronë. Sipas tij, kjo qasje e fragmentuar e regjistrimit ka krijuar sot paqartësi dhe vështirësi në zhvillimin urban dhe në proceset e ndërtimit në këto zona.

Më vonë, gjatë procesit të formalizimit dhe krijimit të sistemit modern kadastral, këto hapësira të paidentifikuara ose të paqarta në dokumentacion janë regjistruar shpesh si pronë shtetërore, pasi mungonte prova e qartë e pronësisë private ose dokumentacioni historik i plotë që të vërtetonte statusin e tyre real. Në të njëjtën kohë, zhvillimi informal urban në disa zona ka bërë që përdorimi faktik i tokës (p.sh. rrugica të përdorura nga komuniteti ose hapësira të ndërtuara pjesërisht nga privatët) të mos përputhet me regjistrimet juridike të mëvonshme. Kjo ka krijuar një hendek midis realitetit në terren dhe regjistrimit ligjor në sistem.

Kjo mospërputhje historike mes “gjendjes faktike” dhe “gjendjes juridike” krijon sot pengesa në zhvillim, pasi çdo ndërhyrje ndërtimore apo investim kërkon qartësim të pronësisë dhe statusit të tokës, gjë që shpesh kërkon procese të gjata verifikimi dhe korrigjimi institucional.

**Znj. Lorena Goxhobelli, ASHK**, sqaroi se kuadri ligjor aktual, përmes VKM-së 827 dhe ligjit 20/2020, trajton çështjet e pronave të vjetra, përfshirë shtëpitë e ndërtuara para vitit 1991 dhe oborret në përdorim apo raste kur dokumentacioni i plotë i pronësisë mungon. Ajo theksoi se këto procese janë ndër më komplekset, pasi shpesh përfshijnë prona të trashëguara dhe konflikte familjare mbi bashkëpronësinë. Për këtë arsye, sistemi aktual ligjor e lidh formalizimin e të drejtave pronësore me posedimin, si një zgjidhje praktike për të adresuar historikun e ndërlikuar të pronësisë pas vitit 1991. Ajo shtoi se, megjithëse kjo qasje mund të sjellë ankesa nga palë të ndryshme, ajo mbetet baza ligjore në fuqi dhe proceset vijnë sipas këtij kuadri për formalizimin e pronave.

**Z. Edvin Preçe, Shoqata Pro-Eksport Albania**, u shpreh se, nga perspektiva e bizneseve, çështjet e evidentuara në anketim reflektojnë një situatë reale, veçanërisht në lidhje me rastet e ripagesave për shërbime. Ai nënvizoi se kjo situatë krijon kosto shtesë për bizneset dhe ndikon negativisht në efikasitetin e proceseve, duke sjellë ngarkesë financiare dhe administrative që shpesh i shtyn subjektet drejt zgjidhjeve të detyruara për të mbyllur procedurat. Ai kërkoi që këto problematika të adresohen nga institucionet përkatëse, me fokus në reduktimin e kostove dhe thjeshtimin e procedurave si për bizneset, ashtu edhe për individët.

**Znj. Lorena Goxhobelli, ASHK**, u shpreh se shqetësimet për tarifën nuk përputhen plotësisht me pritshmëritë e institucionit, duke theksuar se Agjencia Shtetërore e Kadastrës funksionon si institucion me vetëfinansim dhe mbështetet si nga buxheti i shtetit ashtu edhe nga partnerë ndërkombëtarë për procese reformuese dhe digjitalizimi. Ajo sqaroi se tarifën e shërbimeve kadastrale janë të standardizuara dhe relativisht të ulëta në raport me kostot e shërbimeve të ngjashme ligjore, duke përmendur si shembull se një shërbim regjistrimi prone kushton rreth 5,000 lekë, ndërsa shërbimet noteriale për transaksione pronësie mund të arrijnë në shuma shumë më të larta, në varësi të vlerës së pasurisë.

Sipas saj, sistemi aktual parashikon edhe një mekanizëm fleksibiliteti për qytetarët dhe bizneset, përmes disa aplikimeve pa pagesë (tre raste), të cilat u lejojnë përdoruesve të plotësojnë ose korrigjojnë dokumentacionin pa kosto shtesë. Kjo, sipas saj, synon të shmangë penalizimet për pasaktësi apo mungesë dokumentesh në fazën fillestare të aplikimit.

Ajo shtoi se një nga sfidat kryesore të institucionit mbetet cilësia e kthimit të përgjigjeve dhe orientimi i saktë i qytetarëve dhe bizneseve gjatë procesit, duke theksuar se çdo aplikim kërkon kohë dhe burime administrative, ndaj edhe kufizimi i numrit të aplikimeve pa pagesë është vendosur si një ekuilibër midis lehtësimit për qytetarët dhe menaxhimit të kapaciteteve institucionale.

**Z. Spiro Brumbull, Shoqata e Bankave**, theksoi rëndësinë thelbësore të së drejtës së pronësisë për funksionimin e ekonomisë së tregut, duke nënvizuar se pa një sistem të qartë pronësie nuk mund të ketë transaksione apo zhvillim të qëndrueshëm financiar. Ai vlerësoi përmirësimet e bëra në vitet e fundit në administrimin e pronës dhe digjitalizimin, duke pranuar se, pavarësisht problematikave ende ekzistuese, situata aktuale është dukshëm më e mirë krahasuar me periudhat e mëparshme dhe se bashkëpunimi institucional ka ndihmuar në zgjidhjen graduale të çështjeve.

Në vijim, ai ngriti disa çështje konkrete që lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e tregut bankar.

- **Së pari**, theksoi nevojën për përmirësim të aksesit në sistemet kadastrale, duke argumentuar se bankat kanë nevojë për qasje të drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme në informacionin mbi pronat, pasi procesi i kreditimit mbështetet në verifikimin e kolateralit. Sipas tij, ky akses është thelbësor për eficiencën e financimit dhe nuk duhet të mbetet i kufizuar vetëm te noterët apo aktorë të tjerë ndërmjetës.
- **Së dyti**, ngriti problematikën e mospërputhjes në regjistrimin e pronave në faza të ndryshme zhvillimi, veçanërisht për pronat në ndërtim (karabina) të shitura me kontrata porosie, ku sipas tij shpesh mungon një sinkronizim i plotë midis regjistrave ekzistues dhe regjistrimit final të pronësisë, duke krijuar vështirësi në momentin e formalizimit përfundimtar.
- **Së treti**, solli në vëmendje koston e lartë të transaksioneve, duke propozuar që të shqyrtohet vendosja e një tavani për tarifatat noteriale, pasi tarifa në përqindje rritet ndjeshëm në vlera të mëdha transaksionesh dhe krijon barrë të konsiderueshme për bizneset dhe individët.

Në përfundim, falenderoi institucionet për bashkëpunimin dhe theksoi se, megjithëse disa çështje mbeten ende në proces zgjidhjeje, palët janë në një rrugë të përbashkët drejt adresimit të tyre.

**Ministër Delina Ibrahimaj**, në përgjigje të çështjes së aksesit në të dhëna, sqaroi se parimi i ndarjes së informacionit institucional funksionon në mënyrë të ndërsjellë. Ajo theksoi se, ashtu si bankat kanë nevojë për akses në të dhënat kadastrale për qëllime verifikimi dhe kreditimi, edhe institucionet përkatëse operojnë me regjistra të tjerë të specializuar, si Regjistri i Kredive, i cili administrohet nga sistemi bankar dhe Banka e Shqipërisë. Ajo sqaroi se bankat kanë akses të drejtpërdrejtë përmes llogarive të tyre institucionale në sistemet përkatëse për të verifikuar gjendjen e klientëve dhe informacionin financiar, duke konfirmuar kështu funksionimin e ndërveprimit të sistemeve mes institucioneve.

Ajo theksoi gjithashtu se shërbimet e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë me pagesë, në përputhje me modelin e saj të vetëfinancimit, ndërsa një pjesë e zhvillimeve dhe reformave mbështeten nga fondet e Bashkimit Evropian dhe buxheti i shtetit. Sipas saj, procesi i digjitalizimit do të përmirësojë ndjeshëm shpejtësinë dhe lehtësinë e aksesit në informacionin kadastral, duke reduktuar ndjeshëm kohën e marrjes së të dhënave.

Lidhur me tarifatat noteriale, ajo theksoi se çdo ndërhyrje në këtë fushë kërkon një analizë të kujdesshme ligjore dhe institucionale, duke qenë se përfshin një profesion të rregulluar dhe një

dhomë noteriale të pavarur. Për këtë arsye, çdo ndryshim duhet të bëhet përmes një procesi gjithëpërfshirës konsultimi me të gjitha palët e interesuara, përfshirë dhe noterët.

Ajo propozoi që diskutimi të mos mbyllet vetëm me rekomandimet ekzistuese, por të pasohet nga një analizë më e thelluar e proceseve të shërbimeve kadastrale, duke marrë në konsideratë edhe kontributin e biznesit, dhe të rikthehet sërish në tryezë për diskutim të mëtejshëm.

**Znj. Ritva Heikkinen, Delegacioni i BE-së**, vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me institucionet shqiptare në fushën e pronësisë dhe kadastrës, duke theksuar se kjo reformë mbetet thelbësore si për forcimin e shtetit të së drejtës ashtu edhe për përmirësimin e klimës së biznesit. Ajo nënvizoi se problematika e titujve të paqartë të pronësisë vazhdon të jetë një nga pengesat kryesore të raportuara nga bizneset, dhe për këtë arsye trajtohet si një komponent i rëndësishëm i agjendës së reformave dhe procesit të integritetit në BE. Në këtë kuadër, ajo rikonfirmoi mbështetjen e vazhdueshme të Delegacionit të BE-së, në bashkëpunim me institucione si UNOPS dhe Këshilli i Evropës, për modernizimin e sistemit kadastral dhe forcimin e integritetit institucional.

Ajo bëri të ditur se në kuadër të Reformës së Agjendës, Bashkimi Evropian ka alokuar rreth 40 milionë euro për mbështetjen e reformave në këtë fushë, duke theksuar se këto fonde janë të lidhura me progresin real në zbatimin e reformave dhe jo vetëm me institucionet përkatëse.

Më pas, ajo theksoi rëndësinë e përshpejtimit të reformave në fushën e pronësisë në kontekstin e procesit të anëtarësimit në BE, duke vlerësuar angazhimin e institucioneve shqiptare, por njëkohësisht duke nënvizuar se mbeten ende hapa të rëndësishëm për t'u përbushur.

Në mënyrë të veçantë, ajo kërkoi që planet e integritetit të mos mbeten vetëm në nivel miratimi formal, por të zbatohen realisht në praktikë, së bashku me përmirësimin e procedurave të brendshme, digjitalizimin dhe politikat e tokës. Sipas saj, këto hapa janë kyç për përbushjen e objektivave të reformës dhe për përfitimin e plotë të mbështetjes financiare deri në fund të vitit 2027.

**Znj. Lorena Goxhobelli, ASHK**, u shpreh se çështja e aksesit në të dhënat kadastrale lidhet drejtpërdrejt me kuadrin ligjor aktual, i cili i klasifikon të dhënat e pronësisë si informacione konfidenciale. Sipas saj, kjo nuk është një zgjedhje teknike e institucionit, por një vendimarrje politike dhe ligjore, ku shtete të ndryshme kanë qasje të ndryshme: disa vende si Franca, Italia dhe Gjermania ndjekin një model më konservator, ku informacioni mbi pronarët nuk është publik, ndërsa vende si Suedia aplikojnë një model shumë më të hapur të "open data", që përfshin edhe të dhëna të zgjeruara mbi qytetarët.

Ajo sqaroi se në Shqipëri aktualisht është i aksesueshëm vetëm informacioni mbi hartën kadastrale, ndërsa të dhënat mbi pronarët mund të merren vetëm me autorizim të poseduesit të pronës, duke e konsideruar këtë një garanci ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe shmangien e keqpërdorimit të informacionit.

Në vijim, ajo theksoi se çdo ndryshim në nivel transparence dhe hapjeje të të dhënave kërkon analizë të thelluar politike dhe institucionale, duke marrë në konsideratë balancën mes transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Për këtë arsye, institucioni është duke analizuar mundësitë për përmirësimin e ndërveprimit mes sistemeve, veçanërisht mes sistemit të noterëve dhe kadastrës, në mënyrë që të shmangët ri-hyrja manuale e të dhënave dhe të rritet eficientia përmes automatizimit.

Ajo shtoi se këto zhvillime kërkojnë investime dhe mbështetje financiare për përmirësimin e sistemeve digjitale, të cilat aktualisht janë në proces zhvillimi dhe mbështeten pjesërisht nga fondet

e reformave, ndërsa theksoi nevojën për injeksione shtesë për të përshpejtuar transformimin digjital.

Në fund, ajo u ndal edhe te problematika e kontratave të porosisë dhe kalimit në pronësi, duke theksuar nevojën për vijimësi të qartë ligjore dhe dokumentare, ndërsa pranoi se në praktikë kanë ndodhur edhe raste abuzive, për të cilat qytetarët shpesh i drejtohen institucionit, edhe pse zgjidhja e tyre nuk bie gjithmonë në kompetencën e drejtpërdrejtë të kadastrës. Ajo përfundoi duke theksuar se digjitalizimi i plotë i regjistrave pritet të ulë ndjeshëm këto problematika në të ardhmen.

**Z. Reinaldo Pipiria, NAREA**, vlerësoi punën e Këshillit dhe bashkëpunimin me Kadastrën, duke theksuar një ndarje mes përpjekjeve institucionale dhe vullnetit politik, veçanërisht sa i përket çështjes së aksesit në të dhëna. Ai argumentoi se aksesimi i të dhënave është një çështje që lidhet kryesisht me vendimmarrje politike, duke nënvizuar se procesi i integritimit evropian kërkon avancim të shpejtë në fusha si digjitalizimi, ndërveprimi i sistemeve dhe administrimi i pronës.

Z. Pipiria iu referua edhe kuadrit rregullator të BE-së mbi të dhënat (përfshirë direktivat për open data, INSPIRE dhe të dhënat me vlerë të lartë), duke theksuar nevojën për harmonizim me standardet evropiane dhe praktikatat e vendeve anëtare dhe fqinje, të cilat aplikojnë modele të aksesit të bazuara në “interes legjitim”. Ai theksoi se aksesimi i kontrolluar dhe i sigurt në të dhëna do të përmirësonte transparencën, do të lehtësonte transaksionet dhe do të ndihmonte në përmbushjen e detyrimeve të kuadrit AML, duke kontribuar në funksionimin më efikas të tregut të pasurive të paluajtshme dhe procesit të integritimit në BE.

**Z. Bardhyl Baltëza, Shoqata e Ricikluesve**, ngriti një shqetësim mbi mungesën e zbatimit të qëndrueshëm të planifikimit urban në disa zona industriale. Ai solli si shembull rastin e fabrikës së tij të riciklimi që operon në një zonë industriale, rreth së cilës janë lejuar ndërtime banimi, duke krijuar konflikte mes aktivitetit industrial dhe përdorimit rezidencial. Sipas tij, kjo situatë ka sjellë jo vetëm ankesa dhe ndërhyrje institucionale ndaj biznesit, por edhe kufizime në funksionimin normal të aktivitetit prodhues.

Z. Baltëza theksoi se raste të ngjashme janë të dukshme edhe në zona të tjera industriale, ku vendimmarrja për lejet e ndërtimit nuk është gjithmonë në përputhje me destinacionin fillestar të territorit. Ai kërkoi një qasje më të qartë dhe të koordinuar institucionale, duke theksuar nevojën që zonat industriale të ruhen për funksionin e tyre dhe të shmangen ndërhyrjet që krijojnë konflikte të përdorimit të tokës.

**Z. Agim Rrapaj, KASH**, theksoi se digjitalizimi i tokës bujqësore përbën një emergjencë, veçanërisht për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë me investimet në sektorin bujqësor. Ai ngriti shqetësimin se procesi aktual i digjitalizimit nga kadastra shpesh nuk përputhet me prioritetet reale të investimeve të sektorit privat, duke bërë që disa zona me interes të lartë ekonomik të mbeten të pa-digjitalizuara, ndërsa të tjera me më pak rëndësi trajtohen më herët.

Z. Rrapaj kërkoi një koordinim më të ngushtë midis institucioneve dhe sektorit privat, si dhe hartimin e një strategjie të posaçme për digjitalizimin e tokës bujqësore, ku kadastra të ketë rol qendror. Ai theksoi se pa një strategji të tillë të integruar, procesi i digjitalizimit të tokës bujqësore nuk mund të realizohet në mënyrë efektive.

**Znj. Albana Karapanço, AmCham**, vlerësoi diskutimin e Këshillit të Investimeve si shumë relevant për qytetarët dhe biznesin, duke theksuar se Dhomës Amerikane i ka ndjekur nga afër çështjet e pronësisë dhe mbetet e angazhuar për të dhënë rekomandime të mëtejshme.

Ajo nënvizoi se perceptimi i investitorëve për sistemin e pronave formohet jo vetëm nga pritshmëritë, por edhe nga përvoja reale, duke sugjeruar nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të proceseve institucionale. Znj. Karapanço theksoi rëndësinë e standardizimit të proceseve dhe

krijimit të një databaze të strukturuar ankesash, e cila do të ndihmonte në identifikimin dhe adresimin sistematik të problematikave të përsëritura.

Ajo ngriti gjithashtu çështjen e kapaciteteve njerëzore dhe trajnimit në kadastrë, duke vënë në dukje se ndërrimi i shpeshtë i dosjeve midis juristëve dhe kërkimi i përsëritur i dokumentacionit krijon kosto shtesë si për institucionin, ashtu edhe për biznesin. Përmirësimi i këtyre proceseve është thelbësor për rritjen e sigurisë ligjore dhe lehtësimin e investimeve.

**Z. Balazs Revesz, FIAA**, vlerësoi progresin e bërë në përmirësimin dhe digjitalizimin e proceseve në vitet e fundit, por theksoi se sfidat për bizneset mbeten ende të konsiderueshme dhe kërkojnë adresim të vazhdueshëm. Ai nënvizoi se në funksionimin e kadastrës koha është një faktor kritik për biznesin, duke theksuar se vonesat në trajtimin e shërbimeve krijojnë hapësirë për praktika joformale dhe dobësojnë efikasitetin e sistemit. Për këtë arsye, ai propozoi forcimin e llogaridhënies institucionale dhe individuale për respektimin e afateve ligjore, si dhe vendosjen e mekanizmave penalizues dhe kompensues në rastet e vonesave në ofrimin e shërbimeve.

Z. Revesz argumentoi se rritja e llogaridhënies dhe respektimi strikt i afateve përbën një instrument të rëndësishëm edhe për luftën kundër informalitetit dhe korrupsionit, përveç trajnimeve dhe monitorimit. Në vijim, ai theksoi nevojën për të kaluar përtej çështjeve operacionale të kadastrës dhe për të adresuar edhe ndryshimet ligjore të nevojshme, duke shprehur gatishmërinë e Shoqatës së Investitorëve të Huaj për të kontribuar me rekomandime konkrete në këtë proces.

**Znj. Diana Leka, Sekretariati i KI**, u përgjigj duke theksuar se rekomandimi i propozuar lidhet drejtpërdrejt me integritetin dhe llogaridhënien institucionale, të cilat janë pjesë e paketës së rekomandimeve të KI për këtë temë. Ajo u shpreh se në vijim, në bashkëpunim me ASHK-në dhe aktorët përkatës, mund të ndiqen hapa konkretë për ta bërë këtë rekomandim funksional në praktikë, duke e kthyer në masa të zbatueshme.

**Znj. Aurora Sulçe, Dhoma e Biznesit të Diasporës**, falenderoi për prezantimin dhe gjetjet e raportit të Sekretariatit, duke u ndalur veçanërisht te perceptimet e biznesit mbi efektet e digjitalizimit të shërbimeve kadastrale. Ajo vuri në dukje një mospërputhje të evidentuar në raport, ku digjitalizimi perceptohet nga biznesi si faktor që ul kostot operative dhe rrit përfitueshmërinë, por nuk shoqërohet me një perceptim të qartë për uljen e korrupsionit, gjë që sipas saj është kontradiktore me pritshmëritë teorike të reformës.

Znj. Sulçe theksoi se, ndonëse bëhet fjalë për perceptime, korrupsioni mbetet një nga shqetësimet kryesore për biznesin dhe diasporën, veçanërisht në një kontekst ku Shqipëria synon tërheqjen e investimeve të huaja dhe forcimin e lidhjeve ekonomike ndërkombëtare. Ajo sugjeroi nevojën për një analizë më të thelluar mbi efektet reale të digjitalizimit në reduktimin e korrupsionit, për të vlerësuar më qartë efikasitetin e reformës në sektorin e kadastrës dhe ndikimin e saj në klimën e investimeve, duke shtuar se si korrupsioni aktiv ashtu edhe ai pasiv kërkojnë trajtim dhe reflektim institucional më të thelluar. Sipas saj, në parim pritet që treguesit të jenë në korrelacion logjik dhe të lëvizin në të njëjtin drejtim, ndërsa fakti që në grafik shfaqen korrelacione të ndryshme në dimensione të ndryshme tregon nevojën për interpretim më të kujdesshëm të të dhënave, pa nënkuptuar domosdoshmërisht pasaktësi, por duke theksuar domosdoshmërinë e një analize më të thelluar për të kuptuar arsyet e perceptimeve të ndryshme.

**Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI**, u përgjigj se, pavarësisht kërkimeve për studime paraprake, nuk ishte gjetur një referencë e mëparshme mbi problematikën, e cila do të mundësonte një analizë krahasuese në vitin 2026. Lidhur me rekomandimet për korrupsionin, ajo sqaroi se Sekretariati ka qenë i kujdesshëm në formulimin e saktë të pyetjeve në tre shtylla, me qëllim identifikimin e qartë të problematikës dhe shmangien e përsëritjes me rekomandimet e mëparshme. Në këtë kuadër, ajo u dakordësua se çështja kërkon një analizë më të thelluar dhe më të strukturuar.

**Znj. Ines Muçostepa, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë**, theksoi se shqetësimi i ngritur mbi perceptimin e biznesit duhet trajtuar më me fokus, pavarësisht progresit të rëndësishëm të bërë në procesin e digjitalizimit dhe modernizimit të kadastrës. Ajo sugjeroi se një element i rëndësishëm për përmirësim do të ishte përfshirja më aktive e vetë bizneseve në monitorimin e reformës, duke krijuar hapësira institucionale ku zëri i tyre të integrohet në procesin e qeverisjes dhe zbatimit. Sipas saj, kjo do të ndihmonte si në rritjen e transparencës së reformës, ashtu edhe në përmirësimin e perceptimit të saj nga komuniteti i biznesit. Znj. Muçostepa propozoi gjithashtu forcimin e mekanizmave të ankesave dhe trajtimit të tyre, si një instrument konkret për adresimin e pakënaqësive dhe reduktimin e perceptimeve negative që mbeten ende prezente. Në përfundim, ajo theksoi se duhet vlerësuar progresi i bërë në digjitalizim dhe zgjidhjen e problematikave të trashëguara, duke nënvizuar se përmirësimet e mëtejshme mund të fokusohen pikërisht në rritjen e pjesëmarrjes së biznesit dhe forcimin e mekanizmave të reagimit institucional.

**Znj. Gentiana Brati, Dhoma Kombëtare e Noterisë**, falenderoi ASHK-në për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe konstruktiv me Dhomën Kombëtare të Noterisë, duke e vlerësuar atë si të frytshëm dhe të qëndrueshëm në kohë. Ajo theksoi se, pavarësisht sfidave dhe problematikave që dalin në praktikën e përditshme, bashkëpunimi institucional mbetet thelbësor për adresimin dhe zgjidhjen e tyre në mënyrë efektive. Znj. Brati iu referua gjithashtu çështjes së tarifave noteriale, duke vënë në dukje se Dhoma Kombëtare e Noterisë ka paraqitur pranë institucioneve përkatëse një studim të detajuar mbi nevojën për rishikimin e tyre, të cilat nuk janë ndryshuar që nga viti 2013 dhe nuk reflektojnë më realitetin aktual të punës dhe kostove. Ajo ritheksoi rëndësinë e dialogut institucional dhe falenderoi panelin për ngritjen e çështjeve me rëndësi për sektorin.

**Znj. Lorena Goxhobelli, ASHK**, iu përgjigj disa prej çështjeve të ngritura gjatë diskutimit.

- Në lidhje me aksesin në të dhënat e pronësisë, ajo sqaroi se kuadri ligjor shqiptar i konsideron këto të dhëna konfidenciale, si një zgjedhje politike që ndryshon nga vendi në vend. Sipas saj, disa shtete (si Franca, Italia apo Gjermania) zbatojnë qasje më të kufizuara, ndërsa të tjera (si Suedia) kanë model të hapur të të dhënave. Në Shqipëri, aksesin jepet vetëm mbi bazë ligjore ose autorizimi nga pronari, duke theksuar nevojën për balancim mes transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
- Ajo nënvizoi gjithashtu përpjekjet në vijim për rritjen e ndërveprimit të sistemeve dhe përmirësimin e shërbimeve, përfshirë bashkëpunimin me UNOPS dhe partnerë të tjerë në analizën e proceseve të punës. Si shembull u përmend integrimi i sistemit të noterëve me atë të kadastrës, që do të mundësonte transferim automatik të të dhënave dhe ulje të ngarkesës administrative.
- Për sa i përket digjitalizimit dhe reformave institucionale, ajo theksoi se procesi kërkon investime të vazhdueshme dhe koordinim ndër-institucional, përfshirë mbështetjen e AKSHI-t dhe përdorimin e fondeve të reformës për zhvillime të mëtejshme.
- Në lidhje me cilësinë e shërbimit dhe përgjegjësinë institucionale, ajo pranoi se vonesat dhe kthimet e pasakta të përgjigjeve mbeten sfida, por theksoi se ekzistojnë kontrole të brendshme, auditime dhe masa administrative, përfshirë edhe ndëshkime disiplinore kur është e nevojshme. Ajo vuri në dukje edhe ngarkesën e lartë të punës, me rreth 3,000 aplikime në ditë në nivel vendi.
- Për çështjen e korrupsionit, ajo ritheksoi angazhimin e institucionit për zero tolerancë, duke përmendur edhe kallëzime penale të bëra nga ASHK në periudhën e fundit. Sipas saj, korrupsioni duhet trajtuar si fenomen i dyanshëm dhe kërkon përgjegjësi dhe reagim nga të gjitha palët e përfshira.
- Ajo theksoi se janë forcuar reformat e integritetit dhe rregullat e brendshme institucionale, duke përfshirë miratimin e rregullores së re të brendshme pas disa vitesh mungese. Këto reforma synojnë jo vetëm përmirësimin e efikasitetit institucional, por edhe rritjen e përgjegjësisë individuale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve dhe bizneseve.

- Sqaroi se institucioni zhvillon *trajtime të rregullta* dhe miraton çdo vit një plan vjetor trajnimesh, me fokus edhe të çështjet më komplekse si puna me hartat digjitale. Ajo theksoi se, ashtu si në çdo institucion dhe në sektorin privat, sfida kryesore mbeten burimet njerëzore të kufizuara dhe ngarkesa e lartë e punës. Në këtë kuadër, ajo shpjegoi se është duke u diskutuar me UNOPS një rishikim i mënyrës se si mund të përmirësohen proceset e brendshme të punës në ASHK. Sipas saj, synimi është të rishikohen hallkat e procesit të punës dhe të identifikohen pikat ku krijohet burokraci apo diskrecion i tepërt, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e aftësisë profesionale të stafit në mënyrë më të strukturuar dhe praktike.

**Znj. Ana Sekulic Pribicevic, UNOPS**, falenderoi KI, përfaqësuesit e Delegacionit të BE-së, drejtoreshën e ASHK-së dhe partnerët për bashkëpunimin në emër të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian për forcimin e të drejtave të pronësisë dhe përmirësimin e shërbimeve kadastrale në Shqipëri. Ajo theksoi se projekti, i cili zbatohet në mbështetje të procesit të integritetit në BE dhe standardeve të shtetit të së drejtës, është në fazat e para të implementimit, por tashmë përfshin disa aktivitete kryesore, përfshirë digjitalizimin e rreth 33,000 hartave kadastrale dhe fletëve përkatëse, si dhe procesin e kontrollit të cilësisë. Një komponent i rëndësishëm i projektit është edhe rishikimi i proceseve të punës në ASHK, me qëllim përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe digjitalizimit të shërbimeve përgjatë gjithë zinxhirit të vlerës së shërbimeve publike. Ajo sqaroi se aktualisht projekti ndodhet në fazën fillestare, ku po përcaktohet metodologjia, fushëveprimi dhe po zhvillohet angazhimi me aktorët kryesorë institucionalë dhe palët e interesit, duke theksuar se rezultatet e pritshme nuk janë vetëm analitike, por edhe operacionale, përmes standardizimit të proceseve dhe orientimit të tyre drejt përdoruesit. Në mbyllje, ajo vlerësoi rekomandimet dhe kontributin e KI dhe shprehu gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit.

**Znj. Anita Shushku, AREA**, theksoi rëndësinë e temës së sigurisë juridike si themel të çdo investimi dhe element kyç për transformimin ekonomik të vendit. Ajo vuri në dukje se diskutimi duhet të thellohet përtej proceseve të kadastrës, duke u fokusuar në forcimin e sigurisë juridike të pronës dhe zgjerimin e konceptit të saj edhe në të drejtat e investimit, sipas praktikës evropiane. Znj. Shushku ngriti shqetësimin për pasigurinë që mund të përjetojnë qytetarët dhe bizneset në rastet kur kufijtë e pronave ndryshojnë apo kur gabimet historike dhe teknike në hartografi krijojnë paqartësi, duke theksuar nevojën për procedura të qarta, transparente dhe të aksesueshme për trajtimin e këtyre rasteve. Ajo nënvizoi gjithashtu se digjitalizimi, ndonëse një hap modernizues, duhet të shoqërohet me rregulla të forta dhe korrigjim efektiv të gabimeve, në mënyrë që të shmangen surprizat dhe pasiguritë për pronarët. Në përfundim, ajo propozoi që diskutimi në KI të zgjerohet për të përfshirë edhe sigurinë juridike të investimeve si pjesë integrale e reformës, duke theksuar se pa këtë garanci, çdo përpjekje për përmirësim të kadastrës mbetet e pamjaftueshme për të siguruar stabilitetin e klimës së investimeve.

**Znj. Lorena Goxhobelli, ASHK**, u shpreh se siguria juridike e pronës është elementi themelor dhe objektivi final i të gjitha proceseve të lidhura me kadastrën dhe pronësinë, duke u mbështetur si në mbrojtjen kushtetuese ashtu edhe në atë të konventave evropiane. Ajo vuri në dukje se Shqipëria mbart një histori komplekse të titujve të pronësisë, ku proceset pas vitit 1991 – përfshirë tokën bujqësore, kthim-kompensimin dhe regjistrimet fillestare – mbeten ende në zhvillim dhe shpesh të papërfunduara, duke e mbajtur sistemin në një gjendje tranzicioni. Sipas saj, sfidat kryesore lidhen si me mbivendosjet e titujve, të cilat zgjidhen vetëm nëpërmjet gjykatës kur janë juridike, ashtu edhe me mospërputhjet mes titujve të hershëm dhe matjeve aktuale në terren, si pasojë e proceseve fillestare të pasakta të ndarjes së tokës dhe regjistrimit.

Ajo shpjegoi se korrigjimi dhe përditësimi i regjistrit publik mbetet një proces kompleks, që kërkon rishikim dhe konsolidim të të dhënave në nivel zone kadastrale, shpesh me sfida të mëdha sociale dhe juridike, sidomos kur preken të drejtat ekzistuese të pronarëve. Në këtë kuadër, ajo nënvizoi se, ndonëse kadastra është shpesh institucioni ku reflektohen problemet, sfidat janë rezultat i një zinxhiri më të gjerë procesesh historike dhe ligjore, dhe për këtë arsye diskutimi duhet të mbetet i fokusuar te forcimi i sigurisë juridike si prioritet kryesor.

Znj. Laura Plaku, AIDA, theksoi rëndësinë e diskutimit mbi sigurinë juridike të pronës dhe investimeve, duke e konsideruar atë një element thelbësor për klimën e investimeve dhe zhvillimin e projekteve strategjike. Ajo sqaroi se, në rastet e investitorëve strategjikë, sidomos kur projektet zhvillohen në toka shtetërore, siguria juridike e pronës lidhet drejtpërdrejt me sigurinë juridike të investimit, ndërsa për investimet e tjera kjo siguri garantohet përmes kontratave përkatëse, përfshirë ato koncesionare, të cilat parashikojnë mekanizma për mitigimin e rreziqeve. Znj. Plaku nënvizoi se, deri më sot, nuk ka pasur raste kur shteti të ketë shpronësuar pronarë privatë për llogari të investitorëve strategjikë, pavarësisht se një mekanizëm i tillë ekziston në kuadrin ligjor, dhe theksoi se në praktikë procesi kërkon marrëveshje direkte midis investitorit dhe pronarit. Ajo sqaroi gjithashtu se ligji aktual për investimet strategjike është në përfundim të afatit të tij dhe është në proces rishikimi për një kuadër të unifikuar ligjor për investimet, i cili do të trajtojë më qartë edhe çështjet e sigurisë juridike të pronës dhe investimeve, si elemente që kërkojnë vëmendje dhe përforsim të mëtejshëm nga legjislati.

### **Mbyllja e mbledhjes**

Në mbyllje të diskutimeve, znj. Leka falenderoi pjesëmarrësit për kontributet dhe bashkëpunimin, duke theksuar se, pavarësisht tejkalimit të kohës së parashikuar, tema e diskutimit ishte shumë e rëndësishme dhe e ngarkuar me çështje thelbësore që e justifikonin debatin e zgjeruar. Ajo nënvizoi se të gjitha rekomandimet dhe komentet e mbledhura gjatë diskutimit do t'u përcillen institucioneve përkatëse dhe do të ndiqen më tej në formën e një plani veprimi të përbashkët, me qëllim zbatimin dhe monitorimin e tyre në vijim. Në përfundim, ajo e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

## Lista e pjesëmarrjes

### Përfaqësues të qeverisë

1. Znj. Delina Ibrahimaj, Kryetare e Këshillit të Investimeve/Ministre e Ekonomisë dhe Inovacionit
2. Znj. Laura Plaku, CEO, AIDA

### Përfaqësues të biznesit

1. Z. Bashkim Sykja, shef kabineti i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, deleguar nga kryetari i dhomës, z. Nikolin Jaka
2. Znj. Ines Muçostepa, Kryetare, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
3. Z. Balazs Revesz, President, Shoqata e Investitorëve të Huaj (FIAA)
4. Znj. Aurora Sulçe, deleguar nga kryetari i Dhomës Shqiptare e Biznesit të Diasporës, z. Ardian Lekaj
5. Znj. Antonela Hako, Kryetare, Dhoma Ekonomike e Gruas (DHEG)
6. Znj. Albana Karapanço, Kryetare e Komitetit për Çështjet Ligjore dhe Pronësinë Intelektuale, AmCham, deleguar nga presidenti i dhomës, z. Grant Van Cleve
7. Z. Spiro Brumbulli, Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave, deleguar nga Kryetari i Bordit Mbikëqyrës, z. Bledar Shella
8. Z. Denald George Tafani, President, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
9. Znj. Ardita Seknaj, Sekretare e Përgjithshme, ICC Albania, deleguar nga kryetari, z. Nicholas A. Rana
10. Z. Bardhyl Baltëza, CEO, Edipack sh.p.k./Kryetar, Shoqata e Ricikluesve të Shqipërisë (*ad-hoc*)
11. Z. Zak Topuzi, CEO, Hotel Mondial/Nën Kryetar, Shoqata Shqiptare e Turizmit (*ad-hoc*)

### Partnerë ndërkombëtarë

1. Znj. Ritva Heikkinen, Shefe e Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së
2. Znj. Ekaterina Solovova, Drejtore e Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
3. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese, IFC

### **Nuk morën pjesë:**

1. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë
2. Z. Massimiliano Paolucci, Country Manager, Banka Botërore në Shqipërinë
3. Z. Davide Rogai, President, Confindustria Albania
4. Z. Valer Pinderi, President, Shoqata e Tregtisë Elektronike (AECA)

### **Të ftuar:**

1. Z. Philipp Arnold, Zëvendës Shef i Misionit, Ambasada e Zvicrës
2. Znj. Lorena Goxhobelli, Drejtor i Përgjithshëm, ASHK
3. Z. Andi Proko, Drejtor, ASHK
4. Znj. Romina Kostani, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm, AKSHI
5. Znj. Nevila Repishti, Drejtor, Drejtorja e Portalit Qeveritar e-Albania
6. Znj. Gentiana Brati, përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterisë
7. Z. Erjon Harizi, Kryetar i Bordit Drejtues, Shoqata e Ndërtuesve

8. Z. Reinaldo Pipiria, Drejtor Ekzekutiv, Shoqata Kombëtare e Ndërmjetësve të Pasurive të Paluajtshme (NAREA)
9. Z. Agim Rrapaj, Kryetar, KASH
10. Znj. Marinela Jazoj, Drejtore Ekzekutive, Shoqata e Investitorëve të Huaj (FIAA)
11. Z. Juljan Saraçi, Kryetar, Aleanca e Profesionistëve të Lirë
12. Z. Edvin Prençe, Kryetar, Shoqata Pro-Eksport Albania (PEA)
13. Znj. Helisabeta Caco, Drejtore Ekzekutive, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
14. Znj. Marjeta Xhabrahimi (Kodra), Shefe Zyre, Advantage Austria
15. Znj. Tiziana Domi, Koordinatore, SWISSA
16. Znj. Ema Kasapi, Dhoma Britanike e Tregtisë
17. Znj. Anita Shushku, Perfaqesuese, Shoqata AREA
18. Znj. Detiona Troka, Menaxhere e Politikave dhe Avokimit, AmCham
19. Znj. Endrita Xhaferaj, Këshilltare e Lartë, BERZH
20. Z. Peter Danis, Delegacioni i BE-së
21. Znj. Ledia Muço, Këshilltare, Delegacioni i BE-së
22. Znj. Ana Sekulic Pribicevic, Senior Project Manager, UNOPS
23. Znj. Sigita Stafa, Oficere Programesh, Ambasada e Zvicrës
24. Znj. Erinda Fino, Këshilli Kombëtar Ekonomik (KEK)
25. Znj. Aida Hoxha, Bordi i Mbikqyrjes Publike (BMP)